

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5487
E hënë, 28 maj 2018
çmimi 0.40 €

Pacolli mirëpret përfaqësimin diplomatik të Kosovës në Chad dhe Liberi

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

PËR GJENDJEN NË SHËNDETËSI

F. 11

BEKIM
HAXHIU



KUDSI SHERIFI NUK MUND TË JETË KRYEQYTET VETËM I IZRAELITËVE

F. 11



SHKRUAN: DR. MUSTAFA BAJRAMI

AMBASADORI SUEDEZ: VËSHITRË TË JEPEN PARASHIKIME PËR DATËN E LIBERALIZIMIT

F. 7

200 THASË MBETURINA LARGOHEN NGA LUMI ERENIK

F. 10

EKONOMI

IMERI: ATK-ja PËR KATËR MUJ GRUMBULLOI 164.4 MILIONË EURO

F. 8

RRITEN ASTETET E SEKTORIT PENSIONAL TË KOSOVËS

F. 9

SPORT

PRISHTINA FITOI KUPËN

F. 14

BESA, SËRISH KAMPIONE NË HENDBOLL

F. 14

FLET PËR "EPOKËN E RE", RASIM SELMANAJ

FAQE 4-5

Manastiri i Deçanit po bën politikë të gabueshme



Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Rasim Selmanaj, ka kundërshtuar veprimin e Manastirit të Deçanit për ndërprerjen e punimeve në rrugën Deçan - Plavë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Selmanaj ia ka rikujtuar

Sava Janjiqit memorandumin e arritur kohë më parë për asfaltimin e rrugës ekzistuese në gjatësi 2.4 kilometra në zonën e mbrojtur. Sipas tij, në këtë mënyrë Manastiri i Deçanit po bën politikë të gabueshme duke dalë kundër interesit të vet dhe të

komunës. Ish-kryetari i Komunës së Deçanit ka bërë me dije se këto pengesa Manastiri po i bën në mënyrë që komuna ta ndryshojë qëndrimin rreth pronave të "Apiko"-s dhe "Ilirisë", pronësinë e të cilave e kërkon Manastiri i Deçanit

QEVERIA NË PRITJE TË DRAFTIT TË STATUTIT TË ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE

Asociacioni, më së largu deri në fund të vitit

Shefi i delegacionit të Kosovës për dialog teknik, Avni Arifi, ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe do të formohet më

së largu deri në fund të këtij viti, nëse i njëjti do të jetë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e shtetit të Kosovës. Në këtë kontekst, ai ka thënë se janë në pritje të draftit të



statutit të Asociacionit. Arifi ka theksuar se pala e Kosovës është duke u angazhuar maksimalisht për t'i jetësuar sa më parë obligimet ndërkombëtare

FAQE 3

Deputetët të pakënaqur me punën e Kuvendit



Deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk janë të kënaqur me ecurinë e punës së këtij institucioni. Deputeti nga radhët e Nismës Socialdemokrate, Milaim Zeka, ka thënë se Kuvendi është shndërruar në një arkivol, në të cilin

asgjë nuk funksionon. "Ka kohë që as nuk miratojmë ligje, as nuk i plotësojmë vendet boshe nëpër borde", ka thënë Zeka. Edhe deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Ali Lajçi, ka thënë se ka funksionim të dobët të Kuvendit

FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Bushati: Presim hapjen e negociatave me BE-në

TRANË, 27 MAJ - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati, deklaroi se Shqipëria ka bërë përparim të madh dhe pret t'i hapë negociatat për anëtarësim me Bashkimin Evropian. Duke u ndalur te rëndësia e këtij procesi për Ballkanin Perëndimor, kreu

i diplomacisë shqiptare u shpreh se "procesi i pranimi në BE shihet si një instrument, si një nxitje për të transformuar veten, për t'i përmirësuar standardet e jetesës, për ta përmirësuar funksionimin e institucioneve shtetërore, si dhe mënyrën si zhvillohet jeta

publike". Ministri Bushati ka pohuar se në Shqipëri nuk ka asnjë forcë politike që e kundërshton trajektoren e vendit drejt BE-së, por ka rezistencë politike dhe sociale për zbatimin e reformave shtetkonsoliduese që vendi ka ndërmarrë. Duke u ndalur te ky

prioritet kombëtar, ministri Bushati u kujdes të nënvizojë se procesi "nuk po ecën aq shpejt sa kemi dëshiruar" dhe në disa raste njerëzit humbin durimin dhe është shumë e vështirë për t'i ushqyer pritshmërinë e tyre me programe dhe ide që do të zbatohen për 10 vjet ose 15 vjet.



Hapja e negociatave me Shqipërinë, e rëndësishme për interesat e Berlinit

Në raportin e Këshillit Gjerman për Politikën e Jashtme thuhet se dhënia e një drite jeshile për hapjen e negociatave me Shqipërinë është shumë e rëndësishme edhe për interesat e Berlinit zyrtar dhe se asnjë shtet tjetër në rajon nuk ka bërë aq sa Shqipëria për të merituar hapjen e negociatave

BERLIN, 27 MAJ - Ndërsa dita vendimtare, në të cilën vendet anëtare të Bashkimit Evropian do të votojnë për hapjen e mundshme të negociatave me Shqipërinë po afron, në Gjermani shtohen thirrjet që mbështesin kandidaturën e saj. Këshilli Gjerman për Politikën e Jashtme, një "think tank" i pavarur me shumë influencë në jetën politike gjermane, publikoi një raport në të cilin vlerësohet se, pavarësisht prej sfidave ende të rëndësishme me të cilat përballet Shqipëria, "asnjë shtet tjetër në rajon nuk ka bërë aq sa Shqipëria për ta merituar hapjen e negociatave". Sipas këtij raporti, një ndër pikat më të rëndësishme në të cilën ka përparuar Shqipëria është reforma në drejtësi. "Duhet të pranojmë se asnjë vend tjetër në rajon nuk ka bërë një përpjekje serioze për ta reformuar rrënjësisht sistemin e drejtësisë. Ky është një proces i pandalshëm dhe që krijon themelin për sukses në fusha të tjera kyçe, siç është lufta kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar", thuhet në dokument.

Raporti shkon më tej, kur thotë se dhënia e një drite jeshile për hapjen e negociatave është shumë e rëndësishme edhe për vetë interesat e Berlinit zyrtar. "Një 'jo' nga Berlini jo vetëm se do ta destabilizonte Shqipërinë, por do të kishte një ndikim negativ në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor - dhe kështu do t'i kundërshtonte interesat e sigurisë të Gjermanisë. Në të kundërt, një "po" do të ishte një sinjal i qartë se Gjermania dhe BE-ja po shpërblejnë përpjekjet e Shqipërisë për të reformuar, edhe pse ende duhet të kapërcejnë shumë pengesa përpara pranimi", shkruhet në preambulën e këtij dokumenti. Në këtë drejtim, vlerësohet vokacioni i qartë pro-perëndimor i Shqipërisë që, sipas këtij Këshilli, është shumë i rëndësishëm të shpërblehet, për të krijuar një vijë ndarëse nga vendet e Ballkanit që vazhdojnë të flirtojnë me Rusinë, siç ndodh vazhdimisht me Serbinë.

Duke komentuar edhe fenomenin shqetësues të azilkërkuesve, Këshilli Gjerman



për Politikën e Jashtme nënvizon se hapja e negociatave do t'u jepte një perspektivë të qartë të rinjve shqiptarë, duke ndihmuar në zgjidhjen e këtij problemi.

Nga ana tjetër, raporti flet me tone kritike mbi kulturën politike në Shqipëri, duke sulmuar bojkotet parlamentare dhe protestat e organizuar gjatë javëve të fundit. "Ajo që mungon është një kulturë politike që njeh kompromiset jo si një dobësi, por si një element qendror i demokracisë. Në të kaluarën, kjo ka zvarritur reformat dhe penguar funksionimin e institucioneve demokratike. Për shembull, në vitin 2017

PD-ja bojkotoi punën parlamentare për disa muaj, një mekanizëm i përbashkët për debatin politik në Shqipëri", thuhet në dokument.

Publikimi i këtij dokumenti vjen vetëm pak javë përpara se vendet e Bashkimit Evropian të votojnë pas rekomandimit pa kushte të Komisionit Evropian për hapjen e negociatave.

Pavarësisht se Komisioni vlerëson se Shqipëria ka përmbytur të gjitha kushtet për t'u ulur në tryezën e bisedimeve, hapja e negociatave kushtëzohet nga vota për e 28 vendeve anëtare pasi, sipas statutit të organizimit të BE-së, mjafton që një vend i vetëm anëtar të

vendosë veton, që hapja e negociatave të shtyhet për të paktën disa muaj.

Edhe kancelari i Austrisë, Sebastian Kurz, këmbëngul për hapjen e negociatave të shpejta të pranimi në BE për Shqipërinë dhe Maqedoninë. "Kushdo që dëshiron t'i shmangë konfliktet në lagjen tonë në Ballkanin Perëndimor dhe për të ndihmuar në stabilizimin e nevojshëm për vendet në rajon, duhet dhënë një ofertë e besueshme e perspektivës evropiane. Me Shqipërinë dhe Maqedoninë duhet t'i hapim shpejt bisedimet e pranimi", ka thënë politikani konservator.

Tahiri sot në Apel, reagon ambasadori Lu

TRANË, 27 MAJ - Një ditë para seancës gjyqësore në Apel, në të cilën ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri, do ta kërkojë lirinë, reagon ambasadori amerikan Donald Lu, duke bërë një paralajmërim serioz. Lu thotë se "kemi dëgjuar disa raportime nga burime të pavarura

për presione serioze në këtë çështje, përfshirë edhe ryshfete që u janë ofruar gjykatësve".

Ambasadori amerikan në Tiranë, Donald Lu, i bën thirrje shoqërisë civile dhe medieve që ta vëzhgojnë këtë çështje me vëmendje, në mënyrë që vendimi të bazohet mbi provat dhe ligjin dhe jo mbi

presione, kërcënime apo para'. "Askush nuk është mbi ligjin", përfundon mesazhin e tij ambasadori.

Gjykata e la në arrest shtëpie ish-ministrin e Brendshëm, ndërsa prokuroria kishte kërkuar arrest me burg. Avokatët e ish-ministrit thanë se do ta apelonin vendimin

dhe do ta kërkonin lirinë.

Seanca gjyqësore është caktuar sot (e hënë) në mesditë, por në prag të saj, në mënyrë të paprecedentë, ka dhënë paralajmërimin e tij ambasadori amerikan. Ai flet për presion, kërcënime dhe ryshfet që u është ofruar gjyqtarëve për këtë çështje.



Qeveria në pritje të draftit të statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe

Asociacioni, më së largu deri në fund të vitit

Shefi i delegacionit të Kosovës për dialog teknik, Avni Arifi, ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re", se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe do të formohet më së largu deri në fund të këtij viti, nëse i njëjti do të jetë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e shtetit të Kosovës. Në këtë kontekst, ai ka thënë se janë në pritje të draftit të statutit të Asociacionit. Arifi ka theksuar se pala e Kosovës është duke u angazhuar maksimalisht për t'i jetësuar sa më parë obligimet ndërkombëtare

Komunave me Shumicë Serbe nuk duhet të ketë kompetenca ekzekutive dhe autonome të saj. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se formati i Asociacionit nuk duhet t'i dëmtojë interesat e serbëve të Kosovës, por edhe serbët nuk duhet të bëhen instrumente për ndërhyrjet e Serbisë në çështjet e Kosovës. "Nuk duhet pritur kompromise të mëdha, duke pasur parasysh Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, si një detyrim që tashmë është vënë nën vijat e kuqe që pamundësojnë ngritjen e kompetencave ekzekutive dhe autonome të saj. Te kjo çështje ndoshta mund të jepen disa siguri shtesë, se formati i Asociacionit nuk do t'i dëmtojë interesat e veçanta të serbëve të

Kosovës, por këto garanci do të duhej të ishin të dyanshme, që edhe Kosovës t'i garantohet se serbët nuk do të bëhen instrumente për ndërhyrjet e Serbisë në çështjet e Kosovës", ka deklaruar Maliqi. Ndërkohë ish-kryenegociatorja e Kosovës për bisedimet me Serbinë, Edita Tahri, ka ftuar institucionet e Kosovës që sa më shpejt ta formojnë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Ajo ka deklaruar se lënia e formimit të Asociacionit për fazën finale të dialogut është e rrezikshme për Kosovën. "Pikërisht për këtë Asociacioni duhet të zbatohet sa më shpejt. Derisa bëhet hartimi i statutit të Asociacionit, Serbia duhet t'i plotësojë obligimet e veta, duke

zbatuar marrëveshjen për energjinë, ta lejojë hapjen e urës së Ibrit, t'i kthejë regjistrat kadastralë, ta bëjë njohjen e diplomave dhe t'i kryejë obligimet e tjera që i takojnë. Ndërsa Kosova duhet ta përshpejtojë zbatimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në mënyrë që të mos lejojë që kjo çështje të shkojë në pakon e marrëveshjes finale. Marrëveshja për Asociacionin, të cilën ne e kemi arritur në Bruksel, nuk i jep kompetenca ekzekutive Asociacionit. Nëse vonohet Asociacioni dhe hynë në pakon e bisedimeve përfundimtare, ka rrezik që Serbia mund të bëjë kërkesa devijuese jashtë marrëveshjes", ka thënë Tahiri.

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 27 MAJ - Shefi i delegacionit të Kosovës për dialog teknik, Avni Arifi, ka deklaruar të dielën se janë në pritje të draftit të statutit për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se ekipi menaxherial duhet të prodhojë një draft të këtij Asociacioni në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe ligjet në fuqi. "Është aktivizuar ekipi menaxherial dhe është duke draftuar statutin. Ende nuk është prezantuar drafti. Të shpresojmë se ky ekip do të prodhojë një draft që është në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi", ka deklaruar Arifi.

I pyetur nëse çështja e Asociacionit rrezikon të mbetet për finalen e dialogut Kosovë - Serbi, ai nuk e ka mohuar një gjë të tillë, por ka thënë se pala e Kosovës po angazhohet për t'i jetësuar obligimet ndërkombëtare. "Ne po punojmë që obligimet tona ndërkombëtare t'i jetësojmë", ka theksuar Arifi. Sipas tij, Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe mund të formohet më së largu deri në fund të këtij viti, nëse i njëjti do të jetë në përputhje me ligjet e shtetit të Kosovës. "Po, nëse është konform ligjeve të Kosovës", ka thënë Arifi, duke shtuar se në të kundërtën ky Asociacion do ta rrëronte tërësisht sistemin kushtetues të Kosovës. Sipas tij, një asociacion i tillë nuk është në interes të

askujt. "S'ka qysh më pas. Do të rrënohet tërësisht sistemi kushtetues i Kosovës. Nuk është në interes të askujt", është shprehur ai.

Edhe analisti politik Shkëlzen Maliqi ka thënë se Asociacioni i



Pacolli mirëpret përfaqësimin diplomatik të Kosovës në Chad dhe Liberi



PRISHTINË, 27 MAJ (ER) - Zëvendëskryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka mirëpritur zgjerimin e përfaqësimit diplomatik të Republikës së Kosovës në kontinentin afrikan, me akreditimin jorezident të ambasadorit të Republikës së Kosovës nga Senegali në këto dy shtete. "Kosova sot është e

pranishme dhe aktive me përfaqësim diplomatik në kontinentin afrikan si asnjëherë më parë. Me propozimin tonë javën e kaluar është aprovuar themelimi i ambasadës së dytë në Afrikë, e cila do të jetë në lindje të këtij kontinenti, Tanzani. Shtrirja jonë e përfaqësimit diplomatik u zgjerua edhe në Afrikën Qendrore dhe

në atë Perëndimore me akreditimin e ambasadorit tonë jorezident në Republikën e Chadit dhe Republikën e Libirisë", ka thënë Pacolli. Zgjerimi i përfaqësimit dhe pranisë diplomatike të Republikës së Kosovës ka qenë një nga prioritetet kryesore të ministrit Pacolli që nga fillimi i mandatit.

Flet për "Epokën e re", Rasim Selmanaj

Manastiri i Deçanit po bë



Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Rasim Selmanaj, ka kundërshtuar veprimin e Manastirit të Deçanit për ndërprerjen e punimeve në rrugën Deçan - Plavë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Selmanaj ia ka rikujtuar Sava Janjiqit memorandumun e arritur kohë më parë për asfaltimin e rrugës ekzistuese në gjatësi 2.4 kilometra në zonën e mbrojtur. Sipas tij, në këtë mënyrë Manastiri i Deçanit po bën politikë të gabueshme duke dalë kundër interesit të vet dhe të komunës. Ish-kryetari i Komunës së Deçanit ka bërë me dije se këto pengesa Manastiri po i bën në mënyrë që komuna ta ndryshojë qëndrimin rreth pronave të "Apiko"-s dhe "Ilirisë", pronësinë e të cilave e kërkon Manastiri i Deçanit

**EPOKA
ERE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 27 MAJ - Deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Rasim Selmanaj, ka kritikuar Manastirin e Deçanit për ndërprerjen e punimeve në rrugën Deçan - Plavë. Ish-kryetari i Komunës së Deçanit ka theksuar se manastiri po bën poli-

tikë të gabueshme duke penguar rrugën e cila është edhe interes i Kishës Ortodokse Serbe.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se në këtë çështje duhet të inkuadrohen të gjithë faktorët relevantë për ta zhblokuar asfaltimin e rrugës. "Mendoj se Manastiri i Deçanit është duke bërë politika të

gabueshme, sepse vazhdimi i asfaltimit të rrugës ekzistuese është, para së gjithash, në interes të Manastirit. Ne duhet të punojmë që t'i gjejmë rrugët për të ardhur deri te një zgjidhje që të vazhdojnë punimet dhe të asfaltohen rrugët në të dyja anët", ka thënë Selmanaj, i cili ia ka rikujtuar Sava Janjiqit se Komuna dhe Manastiri kishin një memorandum për

asfaltimin e rrugës ekzistuese në gjatësi 2.4 kilometra në zonën e mbrojtur. "Fillimisht Manastiri është pajtuar të rregullohet kjo rrugë por, pasi që unë në atë kohë, sa isha kryetar komune, kam filluar të punoj, ka ndërhyrë përmes KFOR-it dhe i ka ndërprerë punimet. Pastaj i kam ftuar të gjithë faktorët relevantë dhe kemi bërë një memorandum me z. Sava Janjiqin për asfaltimin e rrugës ekzistuese në gjatësi 2.4 kilometra në zonën e mbrojtur. Kurse tani kur është dashur të vazhdohet kjo rrugë, ka penguar Manastiri, sepse është zonë e mbrojtur", është shprehur Selmanaj.

Më tej, ai ka sqaruar se memorandumun ka paraparë asfaltimin e rrugës ekzistuese, e cila ka qenë e gjerë 6 metra, ndërsa për rrugën transit gjerësia është 7

metra. Selmanaj ka vlerësuar se ky problem ka zgjidhje. Sipas tij, fillimisht duhet t'u sqarohet ndërkombëtarëve për punën që do të bëhet aty dhe të merret përkrahja e tyre dhe tek më pas të bisedohet me Manastirin. "Mendoj se ky problem ka zgjidhje. Duhet të punohet dhe të merret përkrahja nëpër adresat që realisht vendosin", ka thënë Selmanaj, duke treguar se pse Manastiri i Deçanit po bën obstrukcione në këtë drejtim. "Ata vazhdimisht thirren në Ligjin për Zonat e Mbrojtura, por pengesat që këta po i krijojnë, po i bëjnë në mënyrë që Komuna e Deçanit ta ndërrojë qëndrimin rreth pronave të 'Apiko'-s dhe 'Ilirisë'. Mendoj se qëndrimi i komunës ndaj këtyre pronave nuk duhet të ndryshojë", është shprehur Selmanaj.

n politikë të gabueshme

"Epoka e re": Z. Selmanaj, sërish Manastiri i Deçanit ka ndërprerë punimet në rrugën Deçan - Plavë. Ju keni qenë ndër të parët që jeni marrë me këtë çështje. Cili është mendimi juaj për këtë veprim të Manastirit?

Selmanaj: Kuvendi i Kosovës ka votuar Ligjin mbi Zonat e Mbrojtura, i cili është një ligj i keq dhe politik. Unë në atë kohë kam qenë deputet dhe nuk e kam votuar këtë ligj. Kurse tani ai ligj është në fuqi, sepse e ka votuar Kuvendi i Republikës Kosovës. Prandaj, Manastiri në të gjitha rrethanat mund të bëjë këso manovrimesh dhe pengesash kur bëhet fjalë për zonën e mbrojtur.

"Epoka e re": Mirëpo ju sa ishit kryetar i Komunës së Deçanit kishit bërë një marrëveshje me Manastirin për ndërtimin e kësaj rruge. Çfarë përmbante ajo marrëveshje?

Selmanaj: Në vitin 2007 kur ishte kryeministër Agim Çeku, tenderi për këtë rrugë ka qenë i hapur dhe ka qenë dita e caktuar për t'i filluar punimet e rrugës transit Deçan - Plavë. Në atë kohë ish-kryeministri është dashur të kthehet në rrugë, sepse ka ndërhyrë Manastiri përmes ambasade dhe janë ndërprerë punimet e rrugës. Kur jam bërë kryetar i komunës këtë rrugë e kam pasur prioritet. Në këtë drejtim fillimisht e kam marrë përkrahjen e ish-kryeministrit Hashim Thaçi që projekti në fjalë të fillojë. Mirëpo, në një moment ish-kryeministri Thaçi më ka thënë se pa përkrahjen e Ambasadës Amerikane nuk mund ta nisim këtë projekt. Pastaj, unë përmes ish-ambasadori të Francës në Prishtinë, z. Fitu, kam arritur të bëj një takim, në të cilin kanë marrë pjesë Hashim Thaçi,

përfaqësuesi i BE-së, Samuel Zhbogar, ish-ambasadori amerikan Christopher Dell, Sava Janjiq, ndërsa unë kam qenë i shoqëruar në këtë takim me dy drejtorë të komunës. Po në këtë takim ka qenë edhe ish-ministrja e Integritit, Vlora Çitaku. Në atë takim kam marrë përkrahjen që ta fillojmë rrugën transit Deçan - Plavë jashtë zonës së mbrojtur, e cila ishte penguar në vitin 2007. Më pas Qeveria e Hashim Thaçit i ka ndarë 1 milion e 100 mijë euro dhe ne kemi filluar punimet duke i asfaltuar 2 kilometra dhe dy të tjera janë hapur. Mirëpo me ardhjen e z. Mustafa në krye të Qeverisë nuk kemi marrë asnjë përkrahje dhe ka pasur stagnim të këtij projekti. Ndërsa, para dy vjetëve në zonën e mbrojtur, prej qendrës së Deçanit deri përtej Manastirit, i kemi asfaltuar 2.5 kilometra rrugë. Pra, fillimisht Manastiri është pajtuar të rregullohet kjo rrugë por, pasi që unë kam filluar të punoj, ka ndërhyrë përmes KFOR-it dhe ka ndërpre punimet. Pastaj i kam ftuar të gjithë faktorët relevantë dhe kemi bërë një memorandum me z. Sava Janjiq për asfaltimin e rrugës ekzistuese në gjatësi 2.4 kilometra në zonën e mbrojtur. Kurse tani kur është dashur të vazhdohet, kjo rrugë i ka penguar Manastiri, sepse është zonë e mbrojtur. Tani janë detyruar që punimet e kësaj rruge të zhvendosen në zonën ku nuk është e mbrojtur. Kështu që, tash për tash e kemi një situatë e cila nuk është e favorshme.

"Epoka e re": Nëse këtë memorandum e ka nënshkruar Komuna e Deçanit dhe Manastiri, pse tash të pengohet asfaltimi i kësaj rruge?

Selmanaj: Memorandumin e

kemi nënshkruar unë si kryetar komune dhe Sava Janjiq. Mirëpo, memorandumimi ka qenë për asfaltimin e rrugës ekzistuese, e cila ka qenë e gjerë gjashtë metra, ndërsa për rrugën transit gjerësia është shtatë metra.

"Epoka e re": Domethënë, tani rruga parashihej të jetë 7 metra më e gjerë se ekzistuesja?

Selmanaj: Po, është paraparë që transiti të jetë shtatë metra. Një pjesë e kësaj rruge, siç dhe thashë, veç është asfaltuar. Mendoj se Manastiri është duke bërë politika të gabueshme, sepse vazhdimi i asfaltimit të rrugës ekzistuese është në interes të Manastirit. Duhet të punojmë t'i gjejmë rrugët për të ardhur deri te një zgjidhje që të vazhdojnë punimet dhe të asfaltohen rrugët në të dyja anët.

"Epoka e re": Meqenëse kur e keni arritur memorandumin i keni pasur në krah zyrtarët ndërkombëtarë në Kosovë, a duhet që sërish ata të inkuadrohen në këtë proces?

Selmanaj: Mendoj se para se të nxirrej në tender kjo pjesë, ku është menduar të fillojnë punimet, është dashur ta marrin përkrahjen të cilën unë e pata marrë në atë kohë. Faji është te ne, ngaqë ai ligj është votuar në Kuvendin e Kosovës. Prandaj, duke e pasur parasysh këtë fakt është dashur të merret përkrahje e pastaj të vazhdohet.

"Epoka e re": Si mendoni se mund të zgjidhet kjo çështje?

Selmanaj: Mendoj se ky problem ka zgjidhje, por duhet të punohet dhe të merret përkrahja nëpër adresat që realisht vendosin.

"Epoka e re": Cilat janë ato

adresa?

Selmanaj: I përmenda më herët. Thashë se në takimin që e kam organizuar unë ka qenë Samul Zhbogari, ish-ambasadori amerikan Christofer Dell, pastaj ka ekzistuar komunikimi me Manastirin. Ani pse ai nuk ka absolutisht të drejtë, mirëpo meqenëse ia kemi dhuruar Kosovës një ligj të keq. Ne tash duhet të punojmë në këto rrethana.

"Epoka e re": A qëndrojnë arsyet se Manastiri është duke i përdorur për ta kundërshtuar vazhdimin e rrugës?

Selmanaj: Manastiri nuk e ka asnjë të drejtë ta bllokojë këtë rrugë. Mirëpo, me një ligj politik ne ia kemi dhënë atë të "drejtë".

"Epoka e re": Kundërshtimi i Manastirit ka të bëjë vetëm me këtë ligj?

Selmanaj: Vazhdimisht thirren në Ligjin për Zonat e Mbrojtura. Realisht, pengesat që këta po i krijojnë, po i bëjnë në mënyrë që Komuna e Deçanit ta ndërrojë qëndrimin rreth pronave të 'Apiko'-s dhe 'Iirisë'. Mendoj se qëndrimi i komunës ndaj këtyre pronave nuk duhet të ndryshojë, pavarësisht se ka marrë vendim Gjykata Kushtetuese e cila s'ka pasur të drejtë të përziej në këtë temë. Dihet se ai kontest është i hapur dhe ato prona nuk mund t'i takojnë Manastirit të Deçanit.

"Epoka e re": Ende nuk kemi ndonjë reagim të institucioneve qendrore për këtë çështje. Duhet të inkuadrohen dhe ta ndihmojnë zgjidhjen e kësaj çështje?

Selmanaj: Natyrisht se njerëzit që udhëheqin shtetin duhet të angazhohen në këtë temë. Besoj se e kanë obligim të angazhohen.

Rruga Deçan - Plavë, Apostolova apelon të respektohet Ligji për Zonën e Mbrojtur

PRISHTINË, 27 MAJ - Shefja e Zyrës së BE-së në Prishtinë, Nataliya Apostolova, ka mbështetur ndërprerjen e punimeve në rrugën Deçan - Plavë, pas ankesës së Kishës Ortodokse Serbe në këtë pjesë. "Është shumë e rëndësishme që Ligji për Zonën e Mbrojtur të Manastirit të Deçanit të respektohet në mënyrë strikte dhe çdo veprim i mundshëm të aprovohet nga Këshilli Implementues dhe Monitorues", ka shkruar ajo në "Twitter". Ndërprerjen e punimeve në

rrugë e ka mbështetur edhe ambasadori i ShBA-së, Greg Delawie. Të shtunën Dioqeza e Rashkës dhe e Prizrenit kishin lëshuar një komunikatë për media, përmes së cilës kanë thënë se i kanë njoftuar përfaqësuesit e BE-së, OSBE-së dhe KFOR-it se "Qeveria e Kosovës ilegalisht ka nisur ndërtimin e rrugëve në rrugën transitore Deçan - Plavë brenda zonës speciale të mbrojtur përreth Manastirit të Deçanit". Më pas kishte reaguar edhe ministri i Infrastrukturës, Pal

Lekaj, i cili kishte thënë se punimet po bëhen jashtë 'zonës së mbrojtur'. E më vonë kishte reaguar edhe Komuna e Deçanit, ku thuhej se mashtrimet e personelit të kishës ortodokse serbe janë të tepruara, dashakeqëse dhe anti-njerëzore.

Të shtunën në mbrëmje misioni i OSBE-së kishte konfirmuar se punimet për ndërtimin e rrugës Plavë - Deçan janë ndërprerë pas kërkesës së Manastirit të Deçanit dhe reagimeve të bashkësisë ndërkombëtare.





FLET PËR "EPOKËN E RE", SAKIP IMERI

ATK-ja për katër muaj grumbulloi 164.4 milionë euro

Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) nga janari deri në prill të këtij viti nga të hyrat e rregullta ka mbledhur 164.4 milionë euro. Imeri ka bërë me dije se, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ka rritje për 21.8 milionë euro apo 15.3 %. Po ashtu, ai ka bërë me dije se janë arkëtuar mbi 56.3 milionë euro të hyra për Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK)

janë mbledhur 10.9 milionë euro apo 7.1 % më shumë të hyra se plani i paraparë. Po gjatë kësaj periudhe janë arkëtuar mbi 56.3 milionë euro të hyra për Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK). Kjo konfirmon se performanca e të hyrave vazhdimisht është duke u rritur, duke marrë parasysh përkushtimin e menaxhmentit të ATK-së për zbatimin e strategjisë 2015-2020, si dhe planeve operative të hartuara për këtë vit. Vlen të përmendet se përmbushja vullnetare është në nivel të kënaqshëm, marrë parasysh edhe vizitat në terren të cilat realizohen, e të cilat nuk kanë karakter vetëm përmbushës, por edhe edukativ (edukimi i tatimpaguesve për kryerjen me kohë të obligimeve tatimore, në mënyrë që mos të ndëshkohen administrativisht)", ka thënë ai. Ndërkaq sa i përket pjesë së veriut, Imeri ka thënë se të hyrat që janë mbledhur nga kjo pjesë janë në vlerë 1.4 milion euro për vitin 2017.

edhe vizitat në terren të cilat realizohen, e të cilat nuk kanë karakter vetëm përmbushës, por edhe edukativ (edukimi i tatimpaguesve për kryerjen me kohë të obligimeve tatimore, në mënyrë që mos të ndëshkohen administrativisht)", ka thënë ai. Ndërkaq sa i përket pjesë së veriut, Imeri ka thënë se të hyrat që janë mbledhur nga kjo pjesë janë në vlerë 1.4 milion euro për vitin 2017.

"Epoka e re": Z. Imeri, sa janë të hyrat e grumbulluara nga ATK-ja deri tani dhe sa kanë qenë vitin e kaluar?

Imeri: Administrata Tatimore e Kosovës vetëm nga janari deri në prill 2018 nga të hyrat e rregullta ka mbledhur 164.4 milionë euro. Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kemi rritje për 21.8 milionë euro apo 15.3 %. Ndërsa në raport me planin

tatimor, mospajisja me arka fiskale, moslëshimi i kuponit fiskal etj.

"Epoka e re": Janë vërejtur aktivitetet e shtuara për mbylljen e lokaleve që ushtrojnë veprimtari të lojërave të fatit. Sa është numri i mbylljes së këtyre veprimtarive?

Imeri: Nga muaji janar i këtij viti e deri më tani Departamenti i Lojërave të Fatit ka realizuar gjithsej 539 vizita, ku ka mbyllur 143 lokale dhe janë lëshuar gjoba në vlerë 761 000 euro. Ndërsa si rezultat i aktiviteteve janë konfiskuar 17 pajisje. Duhet potencuar se vetëm gjatë muajit prill dhe maj janë konfiskuar 30 automate, 5 shtëpiza të basteve, si dhe një tavolinë e pokerit të lojërave live. Në ndjekje penale janë dy persona.

"Epoka e re": Me çfarë norme të të hyrave keni planifikuar ta mbyllni gjashtëmuajorin e parë të këtij viti?

Imeri: Duke pasur parasysh trendin të cilën jemi duke shkuar aktualisht, ku çdo muaj jemi duke e tejkaluar planin, si dhe jemi duke mbledhur më shumë se periudhat e njëjta të vitit të kaluar, konsiderojmë se gjashtëmuajori i parë i vitit 2018 do t'i tejkalojë parashikimet. Në gjashtëmuajorin e parë është e planifikuar të inkasohen 207.5 milionë euro të hyra, mirëpo

ashtu siç e potencova, performanca e të hyrave është mbi nivelin e planifikuar. Misioni i ATK-së është inkurajimi i tatimpaguesve për përmbushje vullnetare, trajtimi transparent dhe gjithëpërfshirës dhe dhënia e këshillave profesionale për implementimin e ligjeve. Ne kemi shkuar në atë drejtim që të krijojmë module që tatimpaguesve t'ua lehtësojmë përmbushjen e obligimeve tatimore.

"Epoka e re": Sa janë të hyrat e grumbulluara në pjesën veriore të Kosovës gjatë këtij viti dhe si është raporti me vitin e kaluar?

Imeri: Të hyrat të cilat janë mbledhur nga pjesa veriore janë në vlerë 1.4 milion euro për vitin 2017.

"Epoka e re": Sa inspektorë janë të angazhuar në veri?

Imeri: Numri i inspektorëve të cilët janë të angazhuar në pjesën veriore është 19.

"Epoka e re": Cili është numri i bizneseve që operojnë në veri dhe për çfarë lloj biznesesh bëhet fjalë?

Imeri: Numri i tatimpaguesve nga pjesa veriore është 1 347, prej tyre individualë janë 727, persona juridikë janë 392 dhe si persona fizikë janë 228. Lloji i bizneseve në atë pjesë kryesisht është tregtia me shumicë dhe pakicë.

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 27 MAJ - Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Sakip Imer, ka thënë se ky institucion nga janari deri në prill të këtij viti nga të hyrat e rregullta ka mbledhur 164.4 milionë euro. Imeri në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ka bërë me dije se janë arkëtuar mbi 56.3 milionë euro të hyra për Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK). "Kjo konfirmon se performanca e të hyrave vazhdimisht është duke u rritur, duke marrë parasysh përkushtimin e menaxhmentit të ATK-së për zbatimin e strategjisë 2015-2020, si dhe planeve operative të hartuara për këtë vit. Vlen të përmendet se përmbushja vullnetare është në nivel të kënaqshëm, marrë parasysh

Rriten asetet e sektorit pensional të Kosovës

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 27 MAJ - Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka njoftuar se sektori pensional vazhdon të jetë sektori i dytë për nga pjesëmarrja në asetet e sistemit financiar me 27.9 për qind të asetëve. Sipas raportit të BQK-së, për vlerësimin e tremujorit të katërt (TM3) të vitit 2017 ecuria pozitive e kontributeve të reja dhe kthimit bruto në investimet e asetëve nga ana e fondeve ndikuan që ky sektor të rritet gradualisht ndër vite. "Sektori pensional vazhdon të jetë sektori i dytë për nga pjesëmarrja në asetet e sistemit financiar me 27.9 për qind të asetëve. Asetet e menaxhuara nga ky sektor vazhduan të rriten edhe gjatë TM4 2017. Asetet e fondeve pensionale janë për 30.1 milionë euro më të

larta kundrejt TM4 2016", është thënë në raportin e BQK-së.

Sipas këtij raporti, investimet e mjeteve jashtë vendit janë kontribuuesit kryesorë të kësaj rritje. "Kjo rritje u ndikua nga investimi më i madh i asetëve jashtë vendit, komponentë që përbën pjesën më të madhe të asetëve të fondeve. Më saktësisht, Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), si përfaqësuese e rreth 99.5 për qind të gjithëj asetëve të fondit pensional, shënoi rritje të investimeve në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës në nivelin prej 20.8 përqindësh, ndërsa investimi në fondet e përbashkëta investive jashtë vendit regjistroi rritje prej 13.4 përqindësh", theksohet në raportin e BQK-së.

Po sipas këtij raporti, fondet pensionale që operojnë në Kosovë kanë strategji të

ndryshme të investimit të asetëve të tyre. "FKPK-ja ndjek një strategji të kujdesshme të investimit, duke siguruar diversifikim të rrezikut në fonde të përbashkëta investuese që menaxhohen nga ndërmarrjet për menaxhim të mjeteve. Në anën tjetër, Fondi Slloven-Kosovar i Pensioneve (FSKP) investon asetet kryesisht në aksione jashtë vendit, pasuar nga asetet e investuara në obligacione si në Kosovë dhe jashtë vendit", është thënë në këtë raport, duke shtuar se zgjerimi i asetëve u ndihmua nga arkëtimet e reja të cilat gjatë tremujorit të katërt të vitit 2017 u shtuan për 4 milionë euro krahas tremujorit të njëjtë të vitit paraprak dhe arritën në 42.2 milionë euro. "Nga këto kontribute të arkëtuara, rreth 99 për qind i takojnë FKPK-së dhe pjesa e mbetur FSKP-së. Rritja e

arkëtimeve u ndikua kryesisht nga numri më i madh i kontribuuesve të rinj në këtë tremujor në krahasim me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Gjithashtu, vlera e arkëtimeve të reja mund të jetë ndikuar deri në një masë edhe nga rritja e të ardhurave të të punësuarve në sektorin publik, si sektor dominues në tregun e punës", është thënë në raportin e BQK-së për vlerësimin e tremujorit të katërt të vitit 2017. Sipas këtij raporti, në këtë tremujor FKPK-ja ka arritur të realizojë një kthim nga investimet e ndërmarrja prej 36.1 milionë eurosh, që është përmirësim i dukshëm me kthimin bruto prej 8.8 milionë të tremujorit të katërt në vitin paraprak. Përderisa FSKP-ja pati një ngadalësim të kthimit bruto nga investimet, duke zbritur në 179.2 mijë euro nga 257.7 mijë

euro në TM4 2016. "Tregjet financiare në ShBA u karakterizuan me luhajtje pozitive si rezultat i lehtësirave fiskale dhe rritjes së BPV-së përtej parashikimeve. Tregu i obligacioneve qeveritare në Eurozonë gjatë tremujorit të katërt u karakterizua me rënie të normave të interesit. Ky zhvillim u ndikua nga vendimi i Bankës Qendrore Evropiane (BQE) për ta vazhduar programin e lehtësimit sasior edhe gjatë vitit 2018, por në vlerë të reduktuar, përkundër që Eurozona përjetoj rritjen më të shpejtë ekonomike në dekadën e fundit. Megjithatë, zhvillimet pozitive në ShBA dhe strategjia investuese ndikuan në performancë të mirë të sektorit pensional, duke siguruar rritje të vlerës së kthimit në investime", është theksuar në raportin e BQK-së.



Ambasadori suedez: Vështirë të jepen parashikime për datën e liberalizimit

PRISHTINË, 27 MAJ - Ambasadori i Mbretërisë së Suedisë në Kosovë, Henrik Nilsson, ka thënë se nuk është koha të jepen parashikime për datën e mundshme për liberalizimin e vizave për Kosovën. Sipas tij, Kosova ka plotësuar të gjitha kriteret që Komisioni

Evropian ia ka përcaktuar për liberalizimin, përpos njërit, e ai është kriteri për luftimin e korrupsionit. Për këtë Komisioni Evropian kërkon raport me vendimet finale gjyqësore për raste të krimit të organizuar dhe atij të nivelit të lartë, si korrupsionit zyrtar.

Nilsson në një intervistë për "KosovaPress" ka thënë se këtu edhe duhet të jetë fokusi i Qeverisë së Kosovës për përmbushjen e këtij kriteri të fundit, që jo vetëm përmbush obligimet në procesin e integritetit evropian të Kosovës, por i sjellë të mira gjithë shoqërisë së

Kosovës. Ai ka thënë se Suedia e mbështet Kosovën në rrugën e saj drejt BE-së, porse angazhimin më të madh politik të shtetit të tij në Kosovë e sheh përmes reformave. "Ne duam ta sjellim Kosovën më afër Bashkimit Evropian dhe duam të asistojmë në këtë",



ka thënë ambasadori Nilsson.

Kudsi Sherifi nuk mund të jetë kryeqytet vetëm i izraelitëve

(Reagim ndaj një shkrimi të Bardhyl Mahmutit me titull "Jerusalemi kryeqytet i Izraelit, është e drejtë legjitime e popullit hebre" që ishte botuar pak ditë më parë nëpër disa portale shqiptare. Në atë shkrim, ku emri im është përmendur disa herë, autori ishte çuditur përse unë Kudsi Sherifin nuk e quaj Jerusalem!)



Shkruan: Dr. Mustafa BAJRAMI

Edhe më parë Bardhyl Mahmuti ka dëshiruar të më kapë për gjuhë për debat me të rreth disa temave që, me sa shihet, nuk i di sa duhet. Dorën në zemër, ai nuk është i padijshëm. Ai është një penë e mprehtë shqiptare dhe me përvojë në tema politike. Shkrimet e tij rreth ngjarjeve të kombit lexohen gjithandej. Ato shkrime i qëndis bukur, ka një gjuhë të rrjedhshme dhe është i pasur në fjalë. Është i butë ndaj bashkëvendimtarëve të vet, por i egër ndaj Islamit, ndaj Turqisë dhe ndaj myslimanëve. Thërë në sy i ka teologët myslimanë shqiptarë dhe i sulmon papërm-bajtshëm. Hëpërhë, Kudsi Sherifin dhe Lindjen e Mesme i njih shumë pak, fatmirësisht jo në përmasa tabullarase. Siç mësojmë nga shkrimet e tij rreth Kudsit, ai çalon në sintetizimin e fakteve rreth një problemi kaq të madh në marrëdhëniet ndërkombëtare. Në mungesë të dijenisë rreth Kudsit, çështjen e Kudsit në mënyrë të çuditshme e lidhë me shqiptarët dhe Serbinë. Kjo metodë është e njohur tek njerëz të cilët, ose s'kanë brumë të mjaftueshëm për ta shtjelluar temën, ose temat i shfrytëzojnë për qëllime të caktuara. Sikur shumë shqiptarëve të tjerë që problemet e mëdha të botës i shikojnë (vetëm) nëpërmes llupës provincialiste të mjegulluar prej ideologjive të çoroditura nacionaliste dhe të lyera fund e krye me të zezë komuniste, edhe ai, duke mos dashur të jetë objektiv ndaj temës, Kudsi Sherifin e trajton si një copëz kartoni që lehtë mund të kapërdihet. Kudsi Sherifin e shpjegon me terme të thata politike, të huazuara nga fjalori i deformuar politik i historisë së Ballkanit. Mbase është i frymëzuar deri në ngufatje nga qoshe të mjegulluara të historisë sonë gjithashtu të

deformuar skajshmërisht nga të këqijat që na i la komunizmi. Do t'i mbetesha borxh këtij miku nëse nuk do t'i përgjigjesha kësaj radhe. Sa për t'ia bërë me dije se gabon shumë kur disa herë qëllimisht dhe në mënyrë tendencioze i keqinterpretim dhe i merr nëpër gojë teologët myslimanë shqiptarë, sa për t'i informuar lexuesit se bota nuk shpjegohet vetëm me terme që janë produkt i mendësisë komuniste nga e cila Bardhyli vështirë të lirohet, aq më shumë, për t'u thënë lexuesve se Kudsi Sherifi kurrë nuk mund të jetë kryeqytet vetëm i jahudive. Kudsi u takon besimtarëve të tri feve monoteiste, mbase edhe të tjerëve që jetojnë aty. Andaj, them unë, edhe nëse dhuna në ndonjë kohë mund ta shkatërrojë një të mirë, ajo, kurrë dhe në asnjë kohë, nuk mund t'ua imponojë njerëzve një të keqe për të mirë. Kudsi Sherifi, Jerusalemi pra, nuk është çështje aq e vogël sa të jetë problem vetëm politik, por është bërthama e të gjitha ngjarjeve të mëdha që kanë ndodhur, që ndodhin dhe që do të ndodhin në histori. Kudsi është krijues i historisë, është historia vetë. Së këndejmi, Kudsi nuk mund të kuptohet drejt nëse qëllimisht apo nga mosdija lihen mënjanë sidomos mesazhet që dalin nga fjalët hyjnore të Zotit. Mesazhe këto që na kanë mbërritur nëpërmes librit hyjnor të fundit të shpallur nga Zoti, por edhe ato që kishin zbritur para Kuranit të Madhërishtëm. Nga ky këndvështrim, nëse çështjen e Kudsit dhe çështje të tjera që ndërlidhen me te, si çështja palestineze, historia osmane, çifutët, kurdët e të krishterët e Lindjes së Mesme, i shikojmë vetëm nën hijen e politikave të tanishme që ndodhin në botë, aq më keq nën hijen e ngjarjeve të dhimbshme që kanë ndodhur në Ballkan, sidomos me gjuhën e historisë fatkeqe të kombit shqiptar, ato kurrë nuk mund të kuptohen drejt e sa duhet. Emocionalja, ideologjitë e ndryshme, komunizmi dhe relativizmi historik janë ato që kanë dëmtuar shumë shqiptarët. E nëse këto që kanë dëmtuar shqiptarinë merren për bazë edhe tek rasti i Kudsit dhe i Lindjes së Mesme, njëjtë do të

shtrembërohet edhe shpjegimi i historisë së atjeshme. Sepse stërpikat komuniste që përlyen realitetin historik të shqiptarëve, sikur që përlyen atë edhe shkrimet e armiqve të tyre, që ende shihen teksa kundërmojnë nëpër faqet e historisë sonë, njëjtë pra do të deformojnë e do ta paraqesin si një karikaturë edhe realitetin historik të Lindjes së Mesme. Për fatin e tij të keq e duke i hyrë të vërtetës në hak dhe, për dallim nga disa të tjerë që janë të hapur e flasin pa brinca në dhëmbë, Bardhyl Mahmuti ndaj meje përdor një gjuhë deri-diku të butë, të fshehur si të gjarprit, por gjithsesi deri në palcë djallëzore. Disa të tjerë janë më të drejtpërdrejtë, janë rrahagjoksë dhe kërcënues, janë të paskrupullt e dashakeqë ndaj myslimanëve shqiptarë e ndaj teologëve islamë të këtij kombi. Mua nuk më pengojë (nuk duhet t'u pengojnë as të tjerëve) ata që nuk mendojnë njëjtë si unë, nuk besojnë si unë, apo nuk i përkasin së njëjtës fe e medhhebe. Siç nënvizon edhe Kurani, unë po mbaj timen e ju mbajeni tuajën. Mirëpo, mua më pengojnë (duhet t'u pengojnë edhe të tjerëve) ata që refuzojnë të tjerët që nuk mendojnë si ata, nuk besojnë si ata, nuk i takojnë fesë dhe medhhebit të tyre. Ata që me qëllim e pa asnjë argument fajësojnë teologët tanë se kinse po punuakan kundër interesave të shqiptarëve, e kanë bërë modë që sa herë të flasin për kombin, flasin kundër fesë islame. I japin të drejtë vetes të dalin në mbrojtje të kombit dhe ua mohojnë të tjerëve të njëjtën gjë. Këta dashakeqë ndiejnë se këtë gjuhë po e ha pazari, andaj bëjnë yrrsh të tregohen tregtarë të zellshëm në shitjen e ideve destruktive në mesin tonë. Gjuha të cilën e përdorin këta njerëz është e formësuar nëpër bungaja të historisë së errët shqiptare, është gjuhë me deformime patologjike. Kjo është gjuha e periudhës komuniste, që vazhdon të jetë gjuha e njerëzve që s'e duan Islamit të jetë pjesë e traditës sonë kombëtare. Folësit e kësaj gjuhe i duan shqiptarët pa islam, i duan shqiptarët të zhveshur nga tradita e tyre shekullore. Shpesh bie në sy fakti se njerëzit të cilët dikur krekoseshin për lidhjet e tyre me komunizmin e për shërbimin që ia bënin atij, sot kanë ndërruar lëkurë dhe flasin me gjuhën kinse të demokracisë. Dikur krenoheshin me të qenit komunistë dhe shanin fenë islame, shanin besimtarët myslimanë, shanin bashkëkombësit e

vetë pse ishin myslimanë, shanin vendet ku islami me shekuj ishte civilizim dhe, të tillët, sot, me të njëjtën gjuhë, por në emër të diçkafit tjetër, shajnë gjithçka që është e shenjtë islame. Sot ata mbajnë anë kinse kah Perëndimi por, në fakt, ata nuk janë të Perëndimit e as me Perëndimin. Ata as i do Perëndimi e as u beson atyre. Ata janë po të njëjtë, janë komunistët, janë dushmanët e Islamit. E pra, ç'të pritet më shumë nga gojë komuniste, të cilat deri dje ushqeheshin me bukën e Moskës, e sot, po të njëjtë, për shkak se ndryshuan kostelacionet ndërkombëtare, e përdorin të njëjtën kinse si gjuhë e demokracisë. Në fakt e në thelb, kjo nuk është gjuha e demokracisë, nuk është gjuha e njerëzve humanë, është gjuha e komunistëve, është gjuha e pastër komuniste. I madh e i vogël e di se Bardhyl Mahmuti deri dje ishte një komunist i rryer e sot është një antidemokrat i përbetuar. Ai në të veten ndoshta arsyetohet pse ishte komunist(!) Mund të thotë sepse Shqipëria ishte komuniste. Por, as ai e as të tjerët kurrë nuk mund t'i fshehin tmerret që i kishte përjetuar populli shqiptar nga komunizmi. Kurrë nuk mund t'i justifikojnë vrasjet e intelektualëve shqiptarë që i kishte bërë komunizmi. Komunizmi vrau hoxhallarë patriotë, vrau priftërinj patriotë, persekutoi e vrau intelektualë, të diplomuar nëpër universitete të Perëndimit. Komunizmi shembi tempujt e fesë dhe i shpalli luftë Perëndimit. E pra, si mund të jenë të mbeturit e kësaj të lige sot njerëz që ia duan të mirën shqiptarisë? Si mund t'u besohet njerëzve të cilët deri dje vranë inteligjencën shqiptare, syrgjynosen penat më të ndritura të kombit dhe shkruan më të keqen e mundshme kundër mendjes së ndritur shqiptare? Si mund të jenë të denjë për respekt njerëzit të cilët shajnë Turqinë, ndërsa atje kemi milionat e shqiptarëve? Si mund të jenë të denjë për respekt njerëzit të cilët shajnë lindjen islame ndërsa shqiptarët i përkasin edhe fesë islame? Si mund të justifikohen apo të pranohen për tanët njerëzit të cilët myslimanëve të këtij vendi orë e çast u thonë të ikën në Anadoll e në Arabi vetëm pse e duan islamit të tyre? Çfarë dallimi ka, pra, mes serbëve fashistë teksa shqiptarëve të Kosovës u thoshin të shporren në Albani, nga soji i këtyre antishqiptarëve sot teksa na thonë të ikim në Turqi e Arabi? Kush janë këta njerëz që në palcë janë komunistë, ndërsa në xhep

mbajnë disa fytyra e të na tregohen neve se ata na qenkan gardianët e shqiptarisë, ndërsa besimtarët myslimanë qenkan për Arabi? Si mund të flasë kështu një njeri që i thotë vetes intelektual e patriot, që në mënyrën më perfide thotë se teologët myslimanë po u munduakan që shqiptarët t'i largojnë nga rruga për Perëndim e t'i çojë rrugës për në Lindje? A është e logjikshme kjo fjalë? Kush janë këta njerëz për të cilët flet Bardhyl Mahmuti? Si e ka emrin ndonjë teolog që paskësh thënë se ne duam të shkojmë drejt Arabisë e jo drejtë Evropës? Apo, a mund të kuptohet ndryshe kjo marri, kjo metodë e njohur serbe për diskreditimin e myslimanëve të këtij vendi, pos si një metodë e njohur e fashizmit serb që e përdori si justifikim për t'i dënuar dhe vranë shqiptarët? Tjetra, Bardhyl Mahmuti në stilin e komunistëve të dikurshëm më kishte "qortuar" mua pse unë nuk i them Kudsi Sherifit Jerusalem! Ore zotni! Si ta quaj unë Kudsi Sherifin Jerusalem kur vetë Kurani e quan Kuds, pejgamberi ynë e ka quajtur Kudsi Sherif, sikur që, edhe tradita islame e quan Kudsi Sherif. Jerusalemin e quajnë Kudsi Sherif edhe të krishterët e Lindjes së Mesme, e quajnë edhe të krishterët e tjerë që jetojnë nëpër botë. Po çfarë të keqe ka nëse unë Jerusalemin e quaj Kudsi Sherif njëjtë sikur e kishte quajtur Salahudin Ejubi, ky gjeneral mysliman i cili, kur hyri në Kuds me ushtrinë e tij, nuk vrau asnjë njeri. Ky njeri që i kishte falë të gjithë dhe në ditën e parë u kishte thënë njerëzve të atjeshëm se, nga sot Kudsi është i të gjithëve. Nuk ka ndasi, nuk ka të lartë ndaj njëri-tjetrit, nënat tuaja ju kanë lind të lirë dhe të gjithë para meje e para ligjit të barabartë jeni. Të gjithë jeni njerëz të lirë!

Më pastaj, teksa po flasin për Kuds, për Jerusalemin, ku për çudinë e njerëzve që njohin gjuhën e argumentit shkencor, por sigurisht jo edhe për çudinë e atyre që janë partizanë të verbër të ideologjive të ndrydhura deri në palcë, Bardhyl Mahmuti me asnjë kriter shkencor, aq më pak njerëzor, i përdor fjalët e ambasadorit palestinez në Beograd se, kinse, ai paska dalë kundër Kosovës e në krah të Serbisë. Edhe nëse paskësh dalë, po çfarë lidhje ka kjo me Kuds dhe me temën që po flasin? A nuk është kjo marri? Bardhyl Mahmuti duhet ta dijë se përderisa Kudsi ishte nën menaxhimin e myslimanëve për hiç më pak se 1200 vjet, aty jetuan

të gjithë në paqe; edhe myslimanët, edhe të krishterët, edhe jahuditë. Dhe, nëse kjo është kështu, e që është fakt i pamohueshëm historik, përse atëherë të mos e quaj edhe unë Kudsën Kuds, e jo Jerusalem?

Dhe për fund. Mësimi kuranor të cilit i mbesin besnikë teologët myslimanë, është po ai mësim kuranor që ka për brumë dashurinë për vendin, për atdheun, për paqen dhe për të gjithë njerëzit që janë njerëz të vërtetë. Këta teologë që Bardhyli i merr nëpër gojë, kanë mësuar nga islami se historia e hebrenjve të cilën e përmend Kurani ka një domethënie të thellë sociale, politike dhe kulturore. Kanë mësuar se historia nuk është shkencë për t'u manipuluar, por është shkollë që na mëson si ta lexojmë të kaluarën për të nxjerrë mësim për të sotmen dhe të ardhmen. Teologët myslimanë e dinë se historia e hebrenjve në Kuran pasqyron një mesazh tepër mbresëlënës, se karakteri i ajeteve të Kuranit që flasin për hebrenjtë kanë domethënie të thellë bashkëjetese dhe kooperimi mes njerëzve. Ne, pra, teologët myslimanë, e dimë se ato mësimet përmbajnë parimin universal të fesë islame, e ai është, pranimi i tjetrit, jo dëbimi, është respektimi i tjetrit dhe ruajtja e hakut të secilit njeri. Islami neve na ka mësuar se ballafaqimi me të ligën, me tiraninë dhe me politikën e korruptuar ishte thirrja e Kuranit drejtuar hebrenjve që në ditët e para të shfaqjes së tij. Gjithsesi kemi mësuar nga Kurani se hebrenjtë të cilët e shihnin veten si popull i zgjedhur, ndërsa të tjerët si shërbëtorë të tyre nuk e pranonin islamin pikërisht për shkak të kësaj thirrjeje. Nga Kurani gjithashtu kemi mësuar se Kuds ishte kibla e parë e myslimanëve, pastaj u bë Qabeja, për ta lënë Kudsën qytet i të gjithëve.

Dhe për fund të fundit, ti dhe të gjithë të tjerët duhet ta dini se, nëse ka dikush që me krenari mund të mburret, që duhet të mburret me mbrojtjen e hebrenjve, janë pikërisht myslimanët. Myslimanët janë ata që mbrojtën hebrenjtë kur të tjerët i dëbuan dhe i vranë. Arabët myslimanë i morën dhe i trajtuan për të barabartë në shtetin e tyre. Osmanlinjtë myslimanë i pranuan me zemër të hapur në shtetin e tyre atëherë kur Evropa po i vriste pa mëshirë. Myslimanët pra kanë të drejtë të kërkojnë hise dhe të jenë pjesë e barabartë edhe e Kudsit Sherifit. Ndërsa komunistët, që ishin vrasësit e tyre gjithandej, janë të fundit që mund t'u dalin në krah hebrenjve, së këndejmi edhe Kudsit Sherifit. E ndër të fundit të kësaj historie mund të jesh ti, Bardhyl Mahmuti, që i sulmon teologët myslimanë dhe me hipokrizi del se, kinse, mbron Kudsit Sherifin. Apo, siç po dëshiron ti ta quash, Jerusalem.

Jerusalemi është i të gjithëve. Është Kudsit Sherif i myslimanëve!

Për gjendjen në shëndetësi



Bekim HAXHIU

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) në muajt e fundit ka filluar dhënien e shërbimeve 24 orë në Kardiologji dhe Onkologji, ndërsa është inauguruar edhe reparti i ri intensiv, ku numri i shtretërve është rritur nga 14 në 27. Për këtë i falënderoj investitorët dhe donatorët, të cilët krijuan hapësirë më të mirë për trajtim të pacientëve. E dini se mungesa e hapësirës së nevojshme në repartin intensiv në QKUK dhe spitalet rajonale ka qenë një vërejtje e imja e vazhdueshme ndaj të gjithë udhëheqësve të Ministrisë së Shëndetësisë. Unë do të vazhdoj të jem kritik edhe më tutje, derisa Ministria e Shëndetësisë t'i përmbushë detyrat që i ka të parapara me ligj. Mirëpo, kujdesi në repartin intensiv nuk do të thotë vetëm sigurimi i shtratit për pacient, por pacientëve duhet t'i sigurohet edhe trajtimi i duhur mjekësor, ekzaminimet e domosdoshme dhe sigurimi i

barnave për trajtim mjekësor, të cilën Ministria e Shëndetësisë nuk është duke e bërë as në këtë udhëheqje.

Për mua vazhdon të mbetet shumë shqetësues fakti i mungesës së barnave nga Lista Esenciale, në veçanti kur familjarët e pacientëve të shtrirë në Intensivë çdo ditë në orën 13:00 duhet ta marrin të shkruar listën e gjatë të barnave që duhet të blejnë.

Situatë e njëjtë me mungesë të furnizimit me barna dhe material shpenzues mjekësor është edhe në Klinikën e Onkologjisë dhe Klinikën e Kardiologjisë, ku personeli mjekësor po bën maksimumin për të ofruar shërbim 24 orë por, për fat të keq, Ministria e Shëndetësisë është ajo që po vazhdon të mos bëjë furnizimet e duhura me rregull. Ministria e Shëndetësisë nuk po arrin t'i përmbushë objektivat dhe detyrat e përcaktuara me ligj, andaj mungesa me barna dhe material shpenzues është shndërruar në dukuri të zakonshme, ku po mungojnë gjërat elementare për trajtim të pacientëve.

Neglizhenca e Ministrisë së Shëndetësisë në furnizim me barna nga Lista Esenciale është për çdo kritikë, pasi arsyetimet se po bëhet revidimi i Listës Esenciale nuk qëndrojnë. Kjo pasi që u bënë dhjetë muaj me

mungesa të furnizimeve dhe do të duhet edhe së paku gjashtë muaj që të përfundojnë procedurat për furnizim me barna nga Lista Esenciale.

Ministrisë ndoshta nuk i ngutet, nuk i bëhet vonë, por pacientët janë ata që kanë nevojë, atyre iu ngutet, ata kanë nevojë menjëherë për barna. Pacientët janë ngopur me premtime e fjalë boshe, si: "do ta bëjmë", "do ta furnizojmë", "do të shikojmë", "do të ..." dhe "do të ..." të pafundme!

Për hir të korrektësisë, duhet t'i përgëzojmë mjekët tanë për punën e madhe që po e bëjnë, sepse ata kanë merita të jashtëzakonshme. Por, mjekët asnjëherë nuk patën mbështetjen e duhur institucionale për t'u ofruar pacientëve përkujdesjen e duhur mjekësore dhe asnjëherë nuk u pagua në mënyrë meritore puna e tyre.

Të kuptohemi qartë, gjendja aktuale e rëndë në shëndetësi nuk është me fajin e mjekëve, por me fajin e politikës, në veçanti udhëheqjes së Ministrisë së Shëndetësisë, e cila nuk ishte në nivelin e duhur të menaxhimit profesional.

Ligjet për reformën në shëndetësi janë votuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2012 dhe 2013, por ende asnjë ministër nuk po arrin ta bëjë të mundur zbatimin e tyre, prandaj vazhdojmë

të kemi problem me sistemin shëndetësor, me mungesa në furnizime me barna dhe pajisje mjekësore, si dhe moszbatim të sigurimeve shëndetësore.

Deri më tani në shëndetësinë tonë janë kryer shumë studime, hulumtime, analiza nga ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë. Është koha e fundit të zbatohen strategjitë dhe programet e miratuara me qëllim të reformimit dhe përmirësimit të sistemit tonë shëndetësor.

I bëj thirrje Ministrisë së Shëndetësisë që t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për përmirësimin e kësaj gjendje alarmante, ta zbatojë reformën, të jetë efektive në veprime për t'i përmirësuar shërbimet shëndetësore për pacientë, të implementojë dhe garantojë një sistem shëndetësor universal, cilësor, të qëndrueshëm dhe të përbalueshëm për të gjithë, të orientuar jo vetëm në trajtim, por edhe në parandalim të sëmundjeve.

Mbështetja ime dhe e të gjithë profesionistëve shëndetësorë do të jetë e vazhdueshme për përmirësim të gjendjes në shëndetësi, duke qenë çdoherë në shërbim të pacientëve.

(Autori është deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës)

Grabitje e armatosur në një barnatore në Prishtinë

PRISHTINË, 27 MAJ - Policia e Kosovës ka njoftuar se të shtunën pas mesnate një barnatore në Prishtinë ka qenë cak i grabitësve. Sipas një njoftimi të policisë, dy persona të armatosur kanë hyrë në barnatore ku kanë grabitur arkën dhe 150 euro para të gatshme. Grabitësit janë larguar nga vendi i ngjarjes dhe policia është duke e hetuar rastin.



Shefja e Zyrës së BE-së promovon malet e Sharrit si potencial për turizëm

SHTËRPECË, 27 MAJ (ER) - Shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Natalya Apostolova, ka postuar një fotografi nga malet e Sharrit

ku ajo të dielën ka pasur një ecje. "Në 2 474 metra lartësi në majën e malit të Sharrit. Ecja malore ofron një potencial të mirë turistik për

Kosovën", ka shkruar ajo në profilin e vet në "Twitter". Në fotografi shihen edhe pjesëtarë të shoqërisë civile të Kosovës bashkë me të.

Podujevasit nisin vjeljen e mjaltit

PODUJEVË, 27 MAJ (ER) - Vjelja e mjaltit në Komunën e Podujevës ka nisur zyrtarisht. Kështu ka njoftuar i pari i kësaj komune, Agim Veliu, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook". "Bashkë me bletarë llapjanë sot zyrtarisht nisëm sezonin e vjeljes së mjaltit. Fatmirësisht, këtë vit po fillojmë me vjeljen e mjaltit të bagremit, që në trevën tonë nuk ndodh shpesh. Duke iu

dëshiruar vjelje të begatshme dhe mjaltë cilësor, kultivuesve llapjanë u premtova rritjen e mbështetjes për bletari, për ta bërë mjaltin e Llapit brend në vend dhe më gjerë. Jam i lumtur që nga bletarët llapjanë kuptova se Podujeva është komuna që më së shumti ka ofruar mbështetje për bletarinë në vend", ka shkruar kryetari i Komunës së Podujevës, Agim Veliu.



Sot mbahet Testi i Maturës në rajonin e Gjilanit dhe të Ferizajt



Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë ka marrë disa vendime, sipas të cilave, parashihen masa ndëshkuese për ata që nuk i përfillin rregullat. Askush nuk lejohet të hyjë në klasë me celular dhe nuk lejohet asnjë lloj materiali tjetër që mund të jetë burim i të dhënave lidhur me përmbajtjen e testit

EPOKA E RE**Qendresa RAMA**

GJILAN, 27 MAJ - Sot (e hënë) mbahet Testi i Maturës 2018 në rajonin e Gjilanit dhe të Ferizajt. Në mënyrë që testi i maturës të shkojë sipas planifikimeve, ministri i Arsimit, Shyqiri Bytyqi, ka marrë disa vendime, sipas të cilave, parashihen masa ndëshkuese për ata që nuk i përfillin rregullat. Në bazë të këtyre vendimeve askush nuk lejohet të hyjë në klasë me celular, përfshirë këtu edhe administratorët, ndërsa komisionarët janë personat kryesorë përgjegjës për qendrat e testimit, kurse nga një mbikëqyrës do të caktohet për pesë administratorë. Përveç celularëve, nuk lejohet asnjë lloj materiali tjetër që mund të jetë burim i të dhënave lidhur me përmbajtjen e testit. Ndërsa kushdo që nuk i respekton rregullat, fillimisht largohet nga procesi i administrimit (administruesit), apo nga testimi (nxënësit), pastaj ndaj të njëjtëve do të merren masa adekuate në përputhje të

rregullave dhe akteve ligjore administrative.

Për dallim nga vitet e tjera, sivjet testi i maturës organizohet për katër ditë me radhë (pjesa e parë) dhe katër ditë pjesa e dytë, të ndara në rajone, ku radha është përcaktuar me short publik, ndërsa pyetësori do të jetë i ndryshëm secilën ditë, me ekuivalencë të njëjtë të vlerësimit. Testi do të ketë 200 kërkesa në të dy pjesët dhe pragu i kalueshmërisë do të jetë 40 për qind sipas ligjit.

DATAT E MBAJTJES SË TESTIT TË MATURËS 2018

Datat e mbajtjes së Testit të Maturës 2018 në afatin e parë do të mbahen sipas kësaj renditje:
Ferizaj - Gjilan: 28. 5. 2018 (dita e parë), 5. 6. 2018 (dita e dytë)
Prishtinë: 29. 5. 2018 (dita e parë), 6. 6. 2018 (dita e dytë)
Prizren - Gjakovë: 30. 5. 2018 (dita e parë), 7. 6. 2018 (dita e dytë)
Pejë - Mitrovicë: 31. 5. 2018 (dita e parë), 8. 6. 2018 (dita e dytë)


Nënkryetari i Prishtinës kosit livadh

PRISHTINË, 27 MAJ (ER) - Nënkryetari i Komunës së Prishtinës, Selim Pacolli, ka vendosur që për fundjavë të mos pushojë. Pacolli ka postuar një fotografi dhe një videoincizim në profilin e vet në "Facebook", në të cilat ai shihet duke kositur në livadh. "Koha e kosës", ka shkruar Pacolli.

Nënkryetari i kryeqytetit njihet për aktivitetet të tilla fizike.

Gjatë kohës së fushatës, Pacolli i kishte hipur një kamionin të kompanisë "Pastrimi" duke e vozitur atë. Selim Pacolli është emëruar nënkryetar i Komunës së Prishtinës pas zgjedhjeve lokale, duke bërë koalicion me Lëvizjen Vetëvendosje, e cila kishte dalë e para me rezultate. Selim Pacolli ka vizituar edhe banorët e Gollakut. Ai gjatë vizitës në fshatin Gregjenik është zotuar se do t'ia kthejë sharmin kësaj pjese më të bukur të Kosovës.





FTESË PËR TENDER

Banka Ekonomike Sh.A. Prishtinë, fton subjektet e interesuara të paraqesin ofertat për:

FURNIZIM ME VETURA TË REJA

Për tu kualifikuar kompanitë duhet të dorëzojnë :

- ofertën financiare, çmimet duhet të jenë me TVSH
- specifikacionet e veturave
- në ofertë duhet të ceket afati i garancionit dhe afati i liferimit
- dokumentacionin e nevojshëm mbi regjistrimin e biznesit dhe TVSH-në
- referencat – kontratat mbi punë të ngjashme.

Afati i dorëzimit të ofertave është deri më 04 Qershor 2018 në ora 15:00.

Palët e interesuara duhet ta kërkojnë dokumentin e tenderit në Zyrën Qendrore të Bankës Ekonomike në Prishtinë, Sheshi Nëna Terezë p.n. ose përmes kërkesës me shkrim në e-mail adresën: prokurimi@bekonomike.com

Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë së paku dy muaj nga data e dorëzimit.

Ofertat në zarf të mbyllur me mbishkrimin "Ofertë për furnizim me vetura të reja" duhet të dorëzohen në recepcion në lokalet e Zyrës Qendrore të Bankës Ekonomike, Sh.A. Prishtinë, Sheshi Nëna Terezë p.n.

Banka Ekonomike mbanë të drejtën të anulojë ose ndryshojë tenderin në cdo kohë.

www.bekonomike.com

Banka Ekonomike Sh.A	info@bekonomike.com
Sheshi Nëna Terezë p.n	Tel. +383 (0) 38 500 500
10000 Prishtinë, Kosovë	Fax: +383 (0) 38 500 507

200 thasë mbeturina largohen nga Lumi Erenik

GJAKOVË, 27 MAJ (ER) - Mbi 100 vullnetarë kanë pastruar Lumën Erenik, nga ku janë larguar 200 thasë me mbeturina. Aksioni i organizuar nga "Let's Do It Kosova", që zgjati për disa orë, është zhvilluar tek ura që e lidh lagjen "Blloku i Ri" me fshatin Moglicë. Aksionit iu bashkuan edhe disa vullnetarë nga "Ta pastrojmë Shqipërinë", si dhe përfaqësues nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Për aksionin e sotëm, kompania turistike "Dita" ka bërë transportin e vullnetarëve, kompania "Meridian" ka ofruar ushqim dhe ujë për vullnetarët, ndërsa thasët për mbeturina janë dhuruar nga Kompania "Scampa". Thasët e mbushur me mbeturina nga vullnetarët janë larguar nga Kompania "Çabрати", punëtorët e së cilës i janë bashkuar aksionit të vullnetarëve për pastrimin e Erenikut. Për organizimin e aksionit ndihmë kanë ofruar edhe Komuna e Gjakovës, Organizata 'IFK', Shoqata e Peshkatarëve dhe organizata të



tjera joqeveritare në këtë komunë.

"Let's Do It Kosova" shpreson se organizimi i këtyre aksioneve do të ndikojë në rritjen e vetëdijesimit tek qytetarët për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike, sidomos lumenjve, gjendja e të cilëve po përkeqësohet dita-ditës. Po ashtu, "Let's Do It Kosova" u ka bërë thirrje edhe institucioneve të mos lejojnë degradimin e hapësirave publike në këtë mënyrë dhe të marrin masa konkrete për përmirësimin e gjendjes së tyre.

Ky aksion për pastrimin e lumit Erenik i ka paraprirë aksionit "Ta pastrojmë Kosovën", i cili organizohet më 5 Qershor, në Ditën Botërore të Mjedisit.

Komuna e Drenasit nis shenjëzimin e rrugëve

Drenas, 27 maj (ER) - Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë e Komunës së Drenasit këtë fundjavë ka nisur

implementimin e projektit të shenjëzimit horizontal të rrugëve. Drejtoresha e kësaj drejtorie, Lumnije Krapit, ka thënë se projekti

ka filluar të implementohet brenda qytetit për të vazhduar pastaj edhe në rrugët e tjera në periferi dhe në vendkalimin e këmbësorëve.

Projekti ka nisur të realizohet këtë ditë për arsye se komunikacioni është më pak i frekuentuar nga automjetet.



E rrallë

Shitet për 103 mijë euro vera e vitit 1774

Një shishe verë që daton në vitin 1774 është shitur në një ankand në Francë për një shumë rekord prej 103 700 eurosh. Vera Vin Jaune (verë e verdhë) vjen nga rajoni lindor i Jura dhe është prodhuar duke përdorur rrush të vjelë gjatë periudhës së mbretit Luigi XVI.



BARSOLETA E DITËS



Një djalë i vogël kalon rrugën me cigare në dorë. E shikon polici dhe i thotë:
- Kaq i vogël me cigare në dorë?
Djali ia kthen:
- Po ti kaq i madh me bilbil në gojë?!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 15:00

“AVENGERS: Infinity War” 3D,


Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlett Johansson, Tom Holland, Zoe Saldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



FOTO E DITES



Dua Lipa gjatë interpretimit të saj para fillimit të ndeshjes (Real Madrid vs Liverpool) në Ligën e Kampionëve në Kiev. /AP/

Në ora 18:00 “ISLE OF DOGS”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

Regjia: Wes Anderson



Në ora 16:00 dhe 20:00

“DEADPOOL 2” (R)

Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

Rolet: Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesly, etj.

Regjia: David Leitch

Gjate vikendit 19 dhe 20 maj, “DEADPOOL 2” do të shfaqet ne ora 13:00 dhe 20:00.



E jashtëzakonshme

Zbulohen dhjetëra krijesa të reja

Një sërë specimesh të reja janë gjetur në ujërat e paeksploruara në ishullin indonezian të Java. Shkencëtarët nga Singapori dhe Indonezia zbuluan më shumë se një duzinë specie të reja gjatë një studimi të deve të thella të pashkelura. Në total, 800 lloje të ndryshme të karkalecave të detit, peshqit,




sfungjer deti dhe molusqeve janë tërhequr nga detet e thella, duke përfshirë edhe një krim 6 cm të gjatë.

Në ora 22:00 “I FEEL PRETTY”

Komedi; 1 orë 50 min

Rolet: Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

Regjia: Abby Kohn & Marc Silverstein



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).



DASHI

Nëse sot nuk e keni ditën shumë të ngarkuar mund të merrni kohë boll për t'ju përkushtuar pasioneve tuaja.



DEMI

Keni marrë përsipër më shumë gjëra nga sa mund të përballoni. Do t'ju nevojitet të ndani mirë objektivat tuaja parësore.



BINJAKËT

Dikush ju ka besuar një sekret sot dhe me këtë gjë ka provuar që ju konsideron vërtet mik. Do të bëni të pamundurën për ta ndihmuar.



GAFORRJA

Nuk mund t'i përgjithësoni gjërat sot. Çdo situatë duhet vlerësuar për atë që i takon jo duke u bashkuar me situata të tjera të ngjashme.



LUANI

Mundohuni të realizoni në praktikë çdo ide që keni menduar kohet e fundit. Kështu do të kuptoni nëse ja vlen vërtet mundimi.



VI RGJERESHA

Keni kërkuar kohë për të bërë disa zgjedhje për ju dhe për partnerin. Në momentin e duhur është mirë ti komunikoni zgjedhjet tuaja.



PESHORJA

Edhe pse jeni përqendruar në disa projekte paralelisht do të arrini t'i realizoni. Nuk ka asgjë të keqe të kërkonte me të mirën nga vetja.



AKREPI

Keni pasur shumë energji negative kohet e fundit dhe i keni shprehur me njerëzit që ju kanë qëndruar pranë.



SHIGJETARI

Edhe pse i jeni përkushtuar shumë një personi të caktuar nuk keni marrë asgjë në shkëmbim. Bëni mirë të ripozicionoheni.



BRICJAPI

Është mirë t'i shembni muret që janë krijuar mes jush dhe një pjesëtari tjetër të familjes. Toleranca është një zgjedhje mjaft e mirë.



UJORI

Sot mundohuni të jeni më produktiv dhe mos krijoni polemika të kota. I detë që keni kërkojnë përkrahje financiare.



PESHQIT

Ndonjëherë pa e vënë re merrni një sjellje distante gati snob. Është mirë të moderoni mënyrën e të sjellurit.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

SPORT

QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

SOUTH KOREA - HONDURAS

GG3+

SARPSBORG - STABAEK

1

HELSINGBORGS - JONKOPING

1

Prishtina fitoi Kupën

Prishtina ka fituar Kupën e Kosovës në edicionin 2017/2018. Kjo skuadër me penalti e mposhti Vëllaznimin, kurse tash do ta përfaqësojë Kosovën në Ligën e Evropës. Ndërkaq Vëllaznimi në edicionin e ardhshëm do të bëjë gara në Ligën e Parë



EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 27 MAJ - FC Prishtina është fituese e Kupës së Kosovës në futboll për edicionin 2017/2018. Kryeqytetasit deri te trofeu i gjashtë në histori erdhën falë fitores ndaj Vëllaznimit në penalti (5-4), pasi koha e rregullt përfundoi 1-1, por edhe dy vazhdimet nga pesëmbëdhjete minuta. Ndeshja finale filloi me një ritëm të lartë, ku të dyja skuadrat u vunë në kërkim të golit.

Në gjashtë minutat e parë Vëllaznimi rezikoi dy herë nëpërmjet Vulës dhe Rudit, por Bekaj ishte në vend. Në anën tjetër edhe Prishtina e pati një rast, por harkimin e Khalidit e devijoi në fundore Vokshi. Në minutën e 12 Mërgim Pevqeli gjuajti plogësht në duart e portierit Muhaxhiri. Në minutën e 21-të Khalid shënoi pas një topi të rikthyer nga mbrojtësi Asare. Raste të mira patën në vijim edhe Khalidi dhe Mankenda për Prishtinën dhe Dushi e Vula për Vëllaznimin, por rezultati i pjesës së parë mbeti 0-1.

Në pjesën e dytë i pari rezikoi Krasniqi, pastaj rast të mirë shënim pati edhe Januzi (59), i cili e kaloi portierin Muhaxhiri, por topin e largoi Dragusha. Pas një ore lojë shtyllën e goditi Asare i Vëllaznimit, derisa në minutën e 79 Dardan Rogova e barazoi rezultatin në 1-

STADIUMI OLIMPIK "ADEM JASHARI"

Shikues: rreth 500

Gjyqtarë: F. Tahiri, F. Sekiraqa, E. Zeqiri, L. Mustafa

Kartonë të verdhë: Bashiru, Bozhoviq (Prishtina), Dushi, Gashi (Vëllaznimi).

Vëllaznimi: Muhaxhiri, Krasniqi, Dragusha, Richard, Vokshi (Bardhoku), Gashi, Dushi, Qorri (E. Gashi), Rogova, Rudi (Myrta), Vula. Trajner: Haxhi Kurhasku.

Prishtina: Bekaj, Jamal, Xhaka, Maxhuni, Bashiru, Ahmeti, Bozoviq, Baftiu (Januzi), Pevqeli (Miftaraj), Mankenda, Khalid (Hoxha). Trajner: Mirel Josa.

1. Sulmuesi gjakovar e shfrytëzoi një reagim të keq të portierit Bekaj dhe nga afërsia e dërgoi topin në rrjetë.

Koha e rregullt përfundoi 1-1, kurse në vazhdimet skuadrat nuk arritën të shënojnë dhe fituesi u vendos në penalti. Prishtina shënoi pesë herë, kurse

Vëllaznimi katër herë. Një penalti e humbi Yll Myrta që e goditi shtyllën e Bekajt. Kjo është hera e dytë brenda një jave që Vëllaznimi pëson humbje në penalti, herën e parë humbi nga skuadra e Ferizajt në ndeshjen e barazhit.

Mitrovica, fituese e Kupës

Skuadra e Mitrovicës është fituese e Kupës së Kosovës në futboll në konkurrencën e femrave, pasi në finalen e zhvilluar në Stadiumin Olimpik "Adem Jashari" në Mitrovicë e ka mposhtur Hajvalinë me rezultat 2-1. Për vashat e Mitrovicës ky është trofeu i parë në këtë garë në histori të klubit. Hajvalia e nisi më mirë ndeshjen dhe qysh në minutën e katërt kaloi në epërsi me golin e Bahtije Miftarit, e cila shënoi me kokë pas harkimit të Kaltrina Bıçkajt.

Megjithatë, futbollistet e Mitrovicës reagan shumë shpejt dhe vetëm pas katër minutash arritën t'i barazojnë shifrat me golin e Gresa Berishës. Pas këtij goli futbollistet mitrovicase vazhduan me lojë edhe më të mirë dhe, si rrjedhojë, arritën ta shënojnë golin e epërsisë në minutën e 22-të, pas asistimit të Fatbardha Osmanit. Këtë epërsi mitrovicaset e administruan mjaft mirë deri në fund dhe këtë ndeshje e mbyllën me fitore.

SHKURT

Besa, sërish kampione në hendboll

Besa FamGas është kampione e Kosovës në hendboll për edicionin 2017\18. Ekipi pejan e festoi titullin të dielën pasdite në kryeqytet kur fitoi ndaj Prishtinës me rezultat 34:28. Ishte kjo ndeshja e dytë e finales së "play-off" -it të kampionatit të Kosovës në hendboll. Besa e ka fituar edhe ndeshjen e parë të luajtur të enjten në Pejë dhe, me rezultat 2:0 në finale, siguroi titullin e kampiones. Besa FamGas ka fituar më herët këtë vit dhe Kupën e Kosovës dhe ka vazhduar të dominojë në hendbollin e Kosovës.

Challendesi kërkon fitore ndaj Shqipërisë

Përfaqësuesja e Kosovës në futboll të dielën ka vazhduar përgatitjet për ndeshjen miqësore ndaj Shqipërisë, e cila zhvillohet më 29 maj në Zvicër. Trajneri i Kosovës, Bernard Challendes, kërkon fitore, edhe pse është vetëm një ndeshje miqësore. "Detyra ime është të punoj dhe ta përgatis ekipin për ndeshjen kundër Shqipërisë dhe për të qenë gati në muajin shtator. Nuk kemi shumë ndryshime. Është mirë që lojtarët t'i kemi të gjithë për t'u përgatitur sa më mirë në muajin shtator. Do t'ua jap mundësinë të gjithë futbollistëve ndaj Shqipërisë", ka thënë Challendes, duke shtuar: "Shqipëria është skuadër shumë e fortë, por për mua e rëndësishme është të përgatitemi kundër Azerbajxhanit në muajin shtator. Gjithsesi kam dëshirë ta fitoj këtë ndeshje".

Ricciardo, "Princi" i ri i Montekarlo

Monte Carlo, 27 maj - Daniel Ricciardo nuk e 'uli gazin' për asnjë moment në Montekarlo, pistë ku dominoi që nga provat e lira dhe deri në fund të garës. Piloti australian i Red Bullit ishte vërtet i jashtëzakonshëm këtë fundjavë, ndërsa pas Pole positionit rekord të së shtunës, arriti ta mbyllë garën sërish në krye. Menjëherë pas tij u renditën Sebastian Vetteli me Ferrarin dhe Lewis Hamiltoni me Mercedesin, dy pilotët që synojnë titullin kampion këtë sezon. Vetëm vendi i katërt për Kimi Raikkonenin, ndërsa pas tij u rendit piloti tjetër i Mercedesit, Valteri Bottas. Pas gjashtë garash të zhvilluara, renditja kryesohet nga Hamiltoni me 110 pikë, i ndjekur nga Vetteli me 96.

Kampioni vendoset në finalen e shtatë

OAKLAND, 27 MAJ - Golden State ka fituar 115-86 ndaj Houstonit në finalen e gjashtë të "play-off"-it në Konferencën e Perëndimit, duke barazuar 3-3 serinë e takimeve, ndaj emri i ekipit kampion në këtë kah të NBA-së do të mësohet në ndeshjen e shtatë dhe të

fundit. Ashtu sikurse pritej, skuadra kampione e Warriorsit ka reaguar në këtë takim, por nuk ka qenë e lehtë pavarësisht prej fitores me 29 pikë diferencë. Houstoni ka kryesuar ndeshjen deri në mesin e periodës së tretë, madje duke u shkëputur edhe deri në 18

pikë, por pa arritur të fitojë dhe të shpallet kampion. Mungesa e Chris Paulit, i dëmtuar, u ndje shumë te miqtë në këtë sfidë, edhe pse Hardeni realizoi 32 pikë, por i pambështetur sa duhet nga pjesa tjetër e skuadrës. Për Golden State, që luante para

fansave të saj, shkëlqeu treshja Curry-Thompson-Durant, që së bashku realizuan 87 pikë, të pandalshëm në parket nga rivalët. Për pasojë, ashtu si në Lindje, fituesi do të shpallet në finalen e shtatë dhe të fundit, ndeshje që do të luhet në fushën e Houstonit.



Reali shkruan historinë në Ligën e Kampionëve



KIEV, 27 MAJ - Real Madridi ka fituar për herë të 13 trofeun e Ligës së Kampionëve pasi ka mposhtur 3-1 Liverpoolin në finalen e luajtur në Kiev. Ky ishte suksesi i tretë radhazi në veprimtarinë më prestigjioze për klube, i katërti në pesë vjetët e fundit. Rekord historik edhe për trajnerin Zinedine Zidane, që e fiton Ligën e Kampionëve për herë të tretë radhazi, si askush tjetër në të kaluarën. Në një pjesë të parë krejtësisht të ekuilibruar episodi kyç i ndeshjes ndodhi kur u mbush gjysmëore lojë. Sergio Ramos dëmtoi Mohamed Salah, duke nxjerrë shpatullën e egjiptianit, në një aksion ku nuk u dha as faull dhe do të diskutohet për një kohë të gjatë nëse spanjollit e bëri qëllimisht apo jo. Salah shtrëngoi dhëmbët por, më kot, në minutën e 31-të ai u zëvendësua me Lallana. Në minutën e pestë të pjesës së dytë, Real Madridi kaloi në avantazh, duke përfutur nga gabimi foshnjarak i portieri Karius. Ky i fundit e përplasi topin në këmbët e Karim Benzemas, për habinë e të gjithëve. Ky ishte goli i parë i një francezi në Ligën e Kampionëve, që pas Zidanës në vitin 2002. Gjithsesi, katër minuta më vonë, gjatë një goditje nga këndi, anglezët u përgjigjën me

barazimin e shënuar nga Saido Mane. Baraspesha zgjati deri në minutën e 64-t, kur erdhi "perla" e Gareth Bales. Pas krosimit të Marcelo, uellsiani, që kishte vetëm tre minuta në fushën e lojës, shënoi me roveshatë një gol të mrekullueshëm, ndoshta më të bukurin në historinë e finaleve të Ligës së Kampionëve. Nëntë minuta para fundit, një gafë tjetër qesharake nga Karius vulosi fatet e ndeshjes. Bale goditi nga rreth 30 metra dhe topi përfundoi në rrjetë, pasi portieri i Liverpoolit nuk e ndali topin.

DEKLARATAT PAS FINALES

Zinedine Zidane, trajner i Real Madridit: "Kemi vuajtur shumë në këtë sezon, por fituam në ndeshjen më të rëndësishme dhe kjo është e jashtëzakonshme. I kishim përgatitur të gjitha mundësitë për këtë ndeshje dhe luajtëm shumë mirë, sidomos në pjesën e dytë. Këtë trofe ua kushtoj futbollistëve të mi".

Jurgen Klopp, trajner i Liverpoolit: "Plani ishte të luajmë për fitore, asgjë tjetër, nuk kisha çfarë të them. Filluam mirë dhe luajtëm ashtu siç donim. Situata me Sergio Ramosin dhe Mohamed Salahun ishte e

keqe dhe befasoi gjithë ekipin. Humbëm çastin pozitiv dhe menjëherë u kundërpërgjigjën. Loris Kariusi e di, e dinë të gjithë. Është turp të pësosh në ndeshje të tilla, në një sezon të tillë. E di për gjendjen e tij, është djalosh fantastik. Gabimi i dytë erdhi si pasojë e të parit".

Cristiano Ronaldo, futbollist i Realit: "Liga e Kampionëve duhet ta ndryshojë emrin dhe të quhet CR7 Liga e Kampionëve. Unë kam fituar pesë, kam qenë përsëri golashënuesi më i mirë, nuk mund të mos jem i kënaqur".

Loris Karius, portier i Liverpoolit: "Nuk po ndiej asgjë momentalisht. Ia humba ekipit tim ndeshjen dhe më vjen keq për të gjithë. Më vjen keq nga të gjithë se gabimet kushtuan shumë. Nëse do të mund të kthehesha në kohë, do të kthehesha. Më vjen keq për ekipin tim. E di se i kam zhgënjyer. Këta gola na kushtuan me titull, faktikisht. Është shumë e vështirë momentalisht, por kjo është jeta e një portieri. Duhet të ecësh sërish me kokën lart. Natyrisht se të gjithë donin të më bënin të buzëqeshur, por gjithandej kishte qetësi sepse të gjithë ishin vërtet të zhgënjyer".

SHKURT

Geta Beqa shpallet kampione, fiton kupën në Madrid

Geta Beqa ka arritur të zë vendin e parë në garën e fitnessit "IFBB ELITE PRO" në kategorinë Wellness Fitness në Madrid. Geta përfaqësoi Kosovën në kategorinë "Wellens Fitness", në garat e fitnessit "IFBB ELITE PRO" të cilat u mbajtën në Madrid nga 26-27 maj. Vitin e kaluar Geta arriti të dalë e para në kampionatin botëror dhe në atë evropian. Suksesi i arritur ka bërë që garuesja e Kosovës të marrë edhe oferta të ndryshme për të stërvitur sportistë anembanë globit.

Ronaldo paralajmëron largimin nga Reali, i kundërpërgjigjet Perezi

Një ditë pas triumfit në Ligën e Kampionëve, Cristiano Ronaldo ka thënë se gjatë ditëve në vijim do të flasë diçka të rëndësishme. Në fakt, deklarata e portugezit është nënkuptuar se ai pritet të largohet gjatë verës nga "Santiago Bernabeu". "Kam diçka për të thënë, por do të flas më gjatë ditët në vijim. Kjo është një çështje që ka kohë që ka nisur dhe paratë nuk janë aspak problem. Do të kem një javë kohë për të menduar për të ardhmen time para se të përqendrohem te kombëtarja dhe Botërori", ka thënë Ronaldo. Ndërsa yllit portugez iu ka kundërpërgjigjur presidenti Florentino Perez. "Të gjithë kanë të drejtën të flasin dhe të thonë atë që mendojnë. Për një skuadër si Real Madridi rëndësi nuk ka individi, por klubi. I rëndësishëm mbetet klubi dhe në një ditë si kjo, që ne u shpallëm kampionë të Evropës, gjëja më e rëndësishme është ta festojmë trofeun. Nuk është hera e parë që ndodh kjo gjë. Gjithnjë flasim për Ronaldon dhe më pas nuk ndodh asgjë. Jam i lumtur që ai ka fituar pesë herë trofeun e Ligës së Kampionëve", ka deklaruar Perez.

Salahi rrezikon pjesëmarrjen në Kupën e Botës

Mohamed Salah luajti vetëm 30 minuta në ndeshjen finale të Ligës së Kampionëve, pasi është lënduar dhe trajneri Jurgen Klopp është detyruar ta zëvendësojë me Lallanen. Mirëpo ai pas këtij lëndimi rrezikon edhe pjesëmarrjen në Kupën e Botës "Rusi 2018". "Dëmtimi i Salahut është serioz. Botërori për të tashmë është në rrezik serioz", ka thënë Salah.

Messi e dëshiron Pjaniqin në vend të Iniestës

Mediet spanjolle raportojnë se Lionel Messi u ka kërkuar drejtuesve të Barcelonës ta sjellin në "Camp Nou" mesfushorin e Juventusit, Miralem Pjaniq. Ish-futbollisti i Romës shihet si lojtari ideal për ta zënë vendin e lënë bosh nga Andres Iniesta, i cili u largua në përfundim të këtij sezoni, për t'u transferuar në Japoni te Vissel Kobe.

Pogba dëshiron të rikthehet në Juventus

Mesfushori i Manchester Unitedit, Paul Pogba, dëshiron të kthehet në Juventus në afatin kalimtar veror, raporton "Tuttosport". Përfaqësuesi francez është kritikuar ashpër në "Old Trafford" që prej transferimit para dy vjetëve dhe tani thuhet se është mallëngjyer për t'u kthyer në Itali. Agjenti i tij, Mino Raiola, është duke punuar me zell për ta arritur marrëveshjen, edhe pse Pogbas do t'i duhej të pranonte ulje page. Ndërkohë, Paris Saint-Germain është duke vëzhguar situatën e tij.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo
Agency of Statistics

Bazuar në nenin 8 pika 3.1, nenit 6 pika 5 dhe nenit 33 të Ligjit Nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2012 për kushtet dhe Mënyrën e Ofrimit të të Dhënave të Fituara me Përpunime të Veçanta të Statistikave Zyrtare si dhe nenit 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Agjencia e Statistikave të Kosovës, bënë:

Rishpallje të Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri i Institucionit	Agjencia e Statistikave të Kosovës
Titulli i punës:	Ekspert i TI-së
Numri i referencës:	ASK-DSBM-001
Tarifa e shërbimit:	900 Euro (Bruto)
Raporton te:	Udhëheqësi i Divizionit-bartësi i projektit
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta - (MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	5 muaj
Orari i punës:	I plotë
Lokacioni dhe numri i ekzekutuesve:	ASK-1

ASK parashikon të vazhdojë pjesëmarrjen e saj në ciklet e raportimit të rregullt për të dhënat statistikore të mbeturinave komunale në Eurostat sipas rregullores së mbeturinave WStatR (EC) No 2150/2002 dhe dërgimin e Raportit të Cilësisë.

Qëllimi kryesor i ASK-së është përmirësimi i mëtejme i cilësisë së të dhënave statistikore. Në mënyrë që ASK ti përmbush këto objektiva, shpall konkurs për Ekspert i TI-së.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Zhvilloni një sistem të bazës së të dhënave dhe një mjet raportimi elektronik për anketën e mbeturinave komunale;
- Zëvendësimi i grumbullimit të të dhënave me përcësor me letër nëpërmjet transmetimit elektronik të të dhënave;
- I ndihmuar dhe mbikëqyrur nga zyrtari përgjegjës i TI-së së ASK-së, do të zhvillojë një bazë të dhënash për AMK në një server të dedikuar enkas për këtë qëllim. Ky lloj i bazës së të dhënave do të lehtësojë pastrimin, përpunimin dhe analizën e të dhënave;
- Caktimi i rregullave të validimit dhe redaktimit do të shkruhen në sistem për të marrë të dhëna cilësore nga të anketuarit. Të dhënat do të ruhen në një SQL Server.
- Ndërfaqja do të jetë bazuar në CAWI (Computer Assisted Web Interview), për mbledhjen e të dhënave të AMK
- CAWI do të dizajnohet dhe zhvillohet në një ndërfaqe miqësore që do të jetë e lehtë për të gjithë të anketuarit
- Të gjitha rezultatet e agreguara të anketës AMK do të integrohen në një platformë për shpërndarjen e të dhënave të ASK-së bazuar në modelin PC-Axis dhe SDMX;
- Hartimi i bazës së të dhënave të AMK duhet të jetë i bazuar në modelin dhe konceptin e bazës së të dhënave të dakorduara;
- Bënë dokumentimin e projektit;
- Në mënyrë rigorozë zbaton masat e sigurisë dhe planeve të rikuperimit të të dhënave;
- Në mbikëqyrje të stafit lokal të TI-së, instalon, konfiguron dhe teston ueb aplikacionin në serverin e ASK-së;
- Bashkëpunon me grupet tjera punuese si dhe ndihmon në kontrollimin, krahasimin, analizimin dhe komentimin e të dhënave dhe rezultateve të tyre.

Shkathësitë e kërkuara:

Diplomë Universitare në fushën e Teknologjisë Informative.

Së paku 4 vjet përvojë punë në fushën përkatëse (e obligueshme).

Kompetenca dhe aftësitë:

- Njohja e gjuhëve koduese siç: C#, C#Pro, JAVA, IITML, CSS;
- Njohuri të avancuara në teknologjitë ASP .NET, MVC si dhe Microsoft SQL Server;
- Njohuri në standardet e SDMX dhe PC-Axis, përparësi;
- Shkathësi në planifikim, hulumtim dhe analiza, kapacitet për të kuptuar proceset, për të koordinuar dhe organizuar punët;
- Ruajtja e konfidencialitetit;
- Të jetë i motivuar dhe aftësi për të punuar në atmosferë interdisciplinare;

Agjencia e Statistikave të Kosovës, mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, nga të gjitha komunitetet.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.

Afati i konkurrimit : Konkursi mbetet i hapur 8 ditë kalendarike nga dita e publikimit në media dhe në web faqen e ASK-së.

Paraqitja e kërkesave: Formularët për aplikim mund të merren në Arhivin e ASK-se, ose mund të tërhiqen nga web faqja e ASK-së në adresën <http://ask.rks-gov.net/>.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, Rr."Zenel Salihu" nr.4 Prishtinë.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen intervistës me gojë.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në zyrën e personelit, në tel: 038- 20031149, prej orës 08:00 - 16: 00.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo
Agency of Statistics

